NDREQJE GABIMI

Në vendimin nr. 316, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", të ndryshuar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 82, viti 2018, f. 5143, bëhet ndreqja e gabimit, konkretisht:

- në fund të lidhjes nr. 5, **"V. TABELA E TARIFAVE DHE MARKAVE"**, të shtohen shënimet me këtë përmbajtje:

"*a) Nëse është depozituar kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës së aplikuar, tarifa për ekzaminim jashtë numrit rendor do të reduktohet në masën 50%.*

b) Tarifa për ripërtëritjen e markës sipas pikës 5.16 do të rritet në masën 50% të vlerës së dhënë në pasqyrë, në rastet kur pagesa e saj kryhet brenda periudhës gjashtë-mujore nga data e përfundimit të periudhës së mbrojtjes.

c) Tarifa për lëshimin e certifikatës së markës në formë elektronike do të reduktohet në masën 20% të vlerës së tarifës së regjistrimit.".

Tabela e saktë me shënimet e shtuara është si më poshtë:

Lidhja nr. 5

V. TABELA E TARIFAVE TË MARKAVE

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
5.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për marke individuale.	7000
5.2	Tarifë për depozitimin e aplikimit për marke kolektive ose certifikuese.	8000
5.3	Tarifë për çdo klasë shtesë.	2500
5.4	Tarifë për kufizimin e listës së mallrave.	5000
5.5	Tarifë për ndarjen e aplikimit fillestar.	6000
5.6	Tarifë për ekzaminim jashtë numrit rendor.	6000
5.7	Tarifë për regjistrimin e markës.	8000
5.8	Tarifë për kundërshtimin e regjistrimit të një marke në Dhomën e Kundërshtimeve.	7000
5.9	Tarifë për rivendosjen në afat.	7000
5.10	Tarifë për zgjatjen e afatit.	2000
5.11	Tarifë për shfuqizimin/ zhvlerësimin e një marke në Dhomën për Shfuqizim/ Zhvlerësim.	7000
5.12	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me kërkesën për shfuqizim/zhvlerësim nga Dhoma për Shfuqizimin/ Zhvlerësim.	10000
5.13	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.	10000
5.14	Tarifë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me apelimin e refuzimit nga Dhoma për Shfuqizim /Zhvlerësim.	10 000
5.15	Tarifë për apelim të refuzimit në Dhomën për Shfuqizim /Zhvlerësim.	5000
5.16	Tarifë për ripërtëritjen e markës.	8000
5.17	Tarifë për ripërtëritjen për çdo klasë shtesë të markës.	4000
5.18	Tarifë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë.	5000
5.19	Tarifë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër.	5000
5.20	Tarifë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në adresë.	1000
5.21	Tarifë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licencës.	5000
5.22	Tarifë për regjistrimin në regjistër të kontratës së pengut.	5000
5.23	Tarifë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore.	5000
5.24	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit.	3000
5.25	Tarifë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës dhe transferimi për shtrirje të mëvonshme.	5000
5.26	Tarifë për lëshim ekstrakti nga regjistri i markave.	1000
5.27	Tarifë për lëshim dublikati të akteve administrative.	1000
5.28	Tarifë për inspektim dosje.	1000

5.29	Tarifë për hetim.	1000
5.30	Tarifë për dorëheqje nga marka e regjistruar.	3000
5.31	Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistër.	2 000
5.32	Tarifë për pasqyrimin e ndryshimeve të tjera në regjistër.	5 000
5.33	Tarifë për transformimin e një aplikimi ndërkombëtar në një aplikim kombëtar.	7 000

"*a) Nëse është depozituar kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës së aplikuar, tarifa për ekzaminim jashtë numrit rendor do të reduktohet në masën 50%.*

b) Tarifa për ripërtëritjen e markës sipas pikës 5.16 do të rritet në masën 50% të vlerës së dhënë në pasqyrë, në rastet kur pagesa e saj kryhet brenda periudhës gjashtë-mujore nga data e përfundimit të periudhës së mbrojtjes.

c) Tarifa për lëshimin e certifikatës së markës në formë elektronike do të reduktohet në masën 20% të vlerës së tarifës së regjistrimit.".